



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Xhaçka takim online me Dovžan: Vlerësojmë angazhimin e Sllovenisë në procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor

2021-07-12 20:58:00



Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, ka zhvilluar një takim online me Sekretarin slloven të Shtetit për Punët e Jashtme, Gasper Dovžan.

Ministrja Xhaçka uroi Slloveninë për marrjen e mandatit të Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian, teksa theksoi se Sllovenia do të jetë një zë i fortë në avancimin e integritit të Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

Kryediplomatja shqiptare theksoi se Ballkani Perëndimor duhet të jetë një fortesë e vlerave evropiane dhe jo pika e dobësisë së sigurisë të saj.

"Një shkëmbim mjaft i frytshëm me Sekretarin e Shtetit për Punët e Jashtme të Sllovenisë, Gašper Dovžan. Vlerësova angazhimin e Sllovenisë kundrejt procesit të integritit evropian të Ballkanit Perëndimor. Mirëpresim Presidencën sllovene të BE dhe punën e tyre gjatë gjysmës së dytë të 2021, gjithashtu dhe avancimin e bashkëpunimit të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian", shkruan ministrja në rrjetet sociale.